



REPUBLIKA E SHQIPERISE
QARKU SHKODER
PREFEKTI

Nr. 318/25 Prot.

Shkodër, me 30.05.2017

URDHËR

Nr. 25 datë 30.05.2017

Për miratimin e plan veprimit “Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2017”, si dhe ngritjen e grupit të punës, për monitorimin e zbatimit të tij

Në funksion të kryerjes së misionit dhe ushtrimit të përgjegjësi (neni 3, 8/b, 10/a, 12, 15/2 të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”), për menaxhimin e sezonit turistik veror 2017 dhe mbarëvajtjen e tij, në përputhje me standardet e përcaktuara ligjore (Ligjin Nr. 93/2015, datë 27.07.2015 “Për turizmin”, Rregulloren “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” (miratuar me VKM Nr. 369, datë 18.05.2016); mbështetur në pikën 1 të nenit 20 të ligjit “Për Prefektin e Qarkut”;

URDHËROJ

I. Miratimin e Planit të Veprimit “Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2017”, sipas tekstit bashkëlidhur.

II. Krijimin e grupit të punës për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit “Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2017”, i cili do të drejtohet nga Prefekti i Qarkut, të përbërë nga:

1. Znj. Greta Bardeli, Kryetare e Këshillit të Qarkut
2. Znj. Voltana Ademi, Kryetare e bashkisë Shkodër
3. Z. Tonin Marinaj, Kryetar i bashkisë Malësi e Madhe
4. Z. Gjon Gjonaj, Kryetar i bashkisë Pukë
5. Z. Fran Tuci, Kryetar i bashkisë Fushë Arrëz
6. Z. Zef Hila, Kryetar i bashkisë Vau i Dejës
7. Z. Gjovalin Loka, Drejtor i Policisë Vendore Shkodër
8. Z. Idajet Hoxha, Drejtor i Policisë Kufitare dhe të Migracionit
9. Z. Hysen Hysa, Drejtor Rajonal i Tatimeve Shkodër
10. Z. Ardit Arbëria, Drejtor Rajonal i Hetimit Tatimor
11. Znj. Taze Lohja, N/Prefekt Malësi e Madhe
12. Z. Gjon Dodaj, N/Prefekt Pukë
13. Z. Agim Dardha, Drejtor i Adm. Rajonale të Zonave të Mbrojtur
14. Z. Zamir Fatusha, Drejtor Rajonal i Shëndetësisë Shkodër
15. Z. Klodian Kovaçi, Drejtor i Agjencisë Rajonale të Mjedisit
16. Z. Shkëlqim Sterkaj, Drejtor Rajonal i Autoritetit Kombëtar Rrugor
17. Znj. Majlinda Laçi, Drejtor Rajonal i Kulturës Kombëtare
18. Znj. Jetmira Kozmai, Drejtor Rajonal i Autoritetit Kombëtar të Ushqimit

19. Z. Ersi Sulejmani, Drejtor Rajonal i OSHEE Sh.A
20. Z. Mark Molla, Drejtor Sh.A Ujësjetllës Kanalizime Shkodër
21. Z. Edmond Tërthorja, Kryeinspektor i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave
22. Z. Nazmi Tusha, Kryetar i Degës Doganës Shkodër

III. Objekti i veprimtarisë së grupit të punës është sigurimi i zbatimit të plan veprimit, nëpërmjet monitorimit, koordinimit dhe bashkërendimit të veprimtarisë së institucioneve dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, në mënyrë periodike, sipas afateve të përcaktuara, nga ana e këtyre njësive dhe Institucioneve të përfshira në plan veprim

IV. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Grupi i punës për monitorimin e zbatimit të plan veprimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore, Institucionet qendrore në nivel vendor dhe administrata e Prefektit

V. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

P R E F E K T I

Paulin RADOVANI

PLAN VEPRIMI

PËR MENAXHIMIN DHE MBARËVAJTJEN E SEZONIT TURISTIK 2017

Nr.	Veprimet që do ndërmerren	Zbatimi i veprimeve, mbikëqyrja dhe monitorimi i zbatimit		
		I ngarkuar për zbatim, mbikëqyrje dhe monitorim		Afati
		Njësia e Vetëqeverisjes Vendore/Institucioni	Kryetari/Drejtori	
1	Organizimi i takimit të Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, me drejtuesit e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe Institucioneve qendrore në nivel vendor, për zbatimin e planit veprimi, për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2017.	Institucioni i Prefekti Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit	Paulin Radovani Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara	Brenda datës 31.05.2017
2	Realizimi i takimeve me njësitë e vetëqeverisjes vendore në zonat bregdetare dhe liqenore për zbatimin e planit të masave për mbarëvajtjen e sezonit veror 2017.	Agjencia Kombëtare e Bregdetit	Auron Tare	Brenda datës 05.06.2017
3	Azhornimi i vazhdueshëm i faqes Web, për promovimin e turizmit dhe publikimin e të dhënave lidhur me zhvillimin e turizmit (Informacione, Raporte, etj)	Këshilli i Qarkut, Bashkitë, Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe e Turizmit	Drejtuesit e Njësive të vetëqeverisjes Vendore dhe Institucioneve	Gjate gjithë sezonit turistik
4	Evidentimi i subjekteve që ushtrojnë veprimtari biznesi në zonat turistike, përfshi edhe subjektet që operojnë në fushën e turizmit (Resorte, Hotele, bar-restorante, shtëpi pushimi, hane, Agjenci turistike e udhëtimit, etj). Mbikëqyrja e ushtrimit të veprimtarisë në përputhje me kriteret e përcaktuara ligjore. Kryerja e kontrolleve, lidhur me llogaritjen dhe	Bashkitë Drejtorja Rajonale Tatimore, Drejtorja Rajonale e Hetimit Tatimor	Voltana Ademi Tonin Marinaj Zef Hila Gjon Gjonaj Fran Tuci Hysen Hysa Ardit Arberia	Gjate gjithë sezonit turistik

	shlyerjen e detyrimeve për tatime, taksa vendore dhe tarifa, si dhe për kontribut sigurimesh shoqërore e shëndetësore			
5	Kryerja e shërbimit në stacione e plazhit, në përputhje me standardet e përcaktuara (Sigurimi i banjove, dusheve, nga ana e subjekteve private të kontraktuara (pas kryerjes së procedurës së përzgjedhjes), të cilat administrojnë sipërfaqen e plazhit (nëpërmjet qiramarrjes) pajisja me kabina, dhoma zhveshje, shërbime higjienike, dushe, pajisje për përgatitjen e pijeve dhe ushqimeve Përzgjedhja e subjekteve të cilat do të administrojnë nëpërmjet qiramarrjes, zonën e bregdetit	Bashkitë Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe e Turizmit	Kryetarët e bashkive Drejtuesit e Agjencie	Gjatë gjithë sezonit
6	Përcaktimi i Zonave për ankorimin e mjeteve lundruese argëtuese, korridoret e hyrje daljeve dhe përgatitja e hartave për plazhet në zbatim të VKM-së, nr. 321 “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve ujore”. Pajisja e korridoreve të hyrje-daljeve të mjeteve lundruese argëtuese me sinjalistikën përkatëse	Bashkia Shkodër (Drejtoria e Turizmit) Agjencia Kombëtare e Bregdetit Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit	Voltana Ademi (Gentian Memaj Auron Tare Idajet Hoxha)	Brenda datës 15.06.2017
7	Përcaktimi i vendparkimeve, në zonat turistike, në veçanti në zonën e plazhit-Velipojë, administrimi dhe marrja e masave për funksionimin normal të tyre.	Bashkitë	Kryetarët e Bashkive	Brenda datës 10.06.2017 dhe gjatë gjithë sezonit

8	Kryerja e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të bardha e të zeza në destinacionet turistike, duke marrë masat për përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit. Monitorimi i cilësisë së ujit të pijshëm	Bashkia Shkodër (“Ujësjellës Kanalizime” Sh.A) Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë	Voltana Ademi Mark Molla Zamir Fatusha	Deri me 01.06.2017 dhe gjate sezonit turistik
9	Të sigurohet furnizimi i vazhdueshëm me energji elektrike i zonave turistike, duke përgatitur e zbatuar plane për eliminimin pa vonesë të difekteve dhe avarive që mund të ndodhin	OShEE Sh.A Shkodër Bashkitë	Drejtori i OShEE Sh.A Shkodër Kryetarët e bashkive	Gjatë gjithë sezonit turistik
10	Kryerja e shërbimit të pastrimit e largimit të mbetjeve urbane (evidentimi dhe menaxhimi i mbetjeve urbane të ngurta dhe mbetjeve të tjera me impakt negativ në mjedis, gjatë rrugëve nacionale dhe atyre që të çojnë në destinacione turistike Plazh-Velipojë, Shirokë, Theth, Kala të Shkodrës; Bregu liqenit M.Madhe, Razem, Ura e Mesit, Kelmend, etj. Evidentimi i pikave ekzistuese të grumbullimit të mbetjeve, përcaktimi i pikave të grumbullimit, duke vendosur kontinier-kazanë; Kryerja e shërbimit të pastrimit në zonën bregdetare, të liqenit të Shkodrës, përfshi edhe bregun e liqenit M.Madhe, Thethit, Razem, Kala), përmirësimi i nivelit të shërbimit dhe krijimi i një mjedisi të pastër në zonat-destinacionet turistike -Monitorimi dhe ushtrimi i kontroleve, lidhur me kryerjen e shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbeturinave nga zonat turistike drejt vendeve të depozitimit të paracaktuara (Lëndefill).	Bashkia Shkodër (Drejtoria e Shërbimeve Publike, Njësitë Administrative, Drejtoria e Turizmit, Policia Bashkiake) Bashkia M.Madhe, Vau i Dejës, Puke e Fushe Arëz. Bashkitë, Agjencia Kombëtare e Bregdetit	Voltana Ademi (Alfred Luleta Administratorët e Nj.A Gentian Memaj Anton Hasanpapaj) Tonin Marinaj Zef Hila Gjon Gjonaj Fran Tuci Kryetarët e Bashkive Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit	Nga data 01.06.2017, si dhe gjate gjithë sezonit

11	Kryerja e shërbimit të gjelbërimit në destinacionet turistike, duke marrë masa për përmirësimin e nivelit të shërbimit (Mbjellja e pemëve dekorative, vendosja e stolave dhe krijimi i rrugëve të brendshme të kalimit në lulishten e në qendër të plazhit dhe ambienteve të tjera të gjelbërta; Vënia në funksionim me orar të zgjatur e Shatervanit për të krijuar një ambient të freskët dhe shlodhës për pushuesit)	Bashkia Shkodër (Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria e Turizmit, Nj.A)	Voltana Ademi Alfred Luleta Gentian Memaj Administratorët e Nj.A	Deri me 01.05.2017, si dhe gjatë sezonit turistik
12	Kryerja e shërbimit të mirëmbajtjes së rrugëve të brendshme në destinacionet turistike dhe ndriçimit në plazh Velipojë (Rikonstruksioni, mirëmbajtja, vijëzimi dhe vendosja e sinjalistikës rrugore, ndriçimi dhe funksionimi i plotë i sistemit të ndriçimit në shëtitoren e plazhit dhe Shirokë)	Bashkia Shkodër (Policia Bashkiake, Drejtoria e Shërbimeve Publike, Nj.A)	Voltana Ademi Alfred Luleta Administratorët e Nj.A	Deri me datën 01.06.2017, si dhe gjatë gjithë sezonit turistik
13	Kryerja e shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi dhe marrja e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të nivelit të këtij shërbimi në zonat turistike	Bashkia Shkodër (Drejtoria e MZSh, Policia bashkiake, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Nj.A)	Voltana Ademi Ridvan Bushati Anton Hasanpapaj Aida Shllaku Administratorët e Nj.A	Gjatë gjithë sezonit turistik
14	Marrja e masave për përballimin e situatave emergjente, që mund të krijohen gjatë sezonit në zonat me destinacion turizmin	Bashkia Shkodër (Drejtoria e Emergjencave dhe MZSh, Policia bashkiake, Drejtoria e Shërbimit Pyjor, Nj.A)	Voltana Ademi Ridvan Bushati Anton Hasanpapaj Aida Shllaku Administratorët e Nj.A	Gjatë gjithë sezonit turistik
15	Në shërbimin të krijimit të sigurisë ushqimore dhe mbrojtjen e popullatës (pushuesve), të mbikëqyret, duke monitoruar e ushtruar kontrole të vazhdueshme në subjektet e prodhimit dhe furnizimit të produkteve ushqimore në të gjithë territoret turistike dhe jo	Bashkitë Drejtoria Rajonale AKU Drejtoria e Bujqësisë	Kryetarët e Bashkive Jetmira Kozmaj Mustaf Kraja	Gjatë gjithë sezonit turistik

	vetëm, lidhur me zbatimin e standardeve të përcaktuara.			
16	Dhënia e informacionit turistik për të gjithë të interesuarit, nëpërmjet funksionimit dhe vënies në efikasitet të plotë të zyrave të Informacionit Turistik në Shkodër, Velipojë dhe Theth	Bashkia Shkodër (Drejtoria e Turizmit, Zyra me një Ndalës)	Voltana Ademi Gentian Memaj Gjergj Kurti	Gjatë gjithë sezonit turistik
17	Programimi, publikimi sipas kalendarit të miratuar dhe organizimi i aktiviteteve gjatë sezonit	Bashkitë	Kryetarët e Bashkive (Drejtoret dhe Zyrat përkatëse të arsimit, kulturës dhe sportit)	Gjatë gjithë sezonit turistik
18	Krijimi i itinerareve turistike gjatë vijës së bregut të liqenit dhe shtigjeve turistike në Parkun Natyror Rajonal Shkrel	Bashkia Malësi e Madhe	Tonin Marinaj Ertit Markaj	Brenda datës 10 Qershor 2017
19	Sigurimi i një shërbimi të vazhdueshëm shëndetësor në zonat turistike, veçanërisht në plazh-Velipojë ku ka një përqendrim të madh pushuesish	Bashkitë Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë (Qendrat Shëndetësore)	Kryetarët e Bashkive Zamir Fatusha, Drejtoret e Q. Shëndetësore	Gjatë gjithë sezonit turistik
20	Monitorimi i parametrevë të ujërave të detit dhe liqenit, nëpërmjet kryerjes së analizave përkatëse	Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë	Zamir Fatusha	Gjatë gjithë sezonit turistik

21	<p>Në fushën e rendit dhe sigurisë publike</p> <p>a. DVPQ Shkodër dhe Komisaritet e Policisë, të bashkërendojnë masat me institucionet e tjera shtetërore dhe organet e qeverisjes vendore me qëllim, koordinimin e veprimeve të përbashkëta për sezonin turistik, në zbatim të Urdhrit nr. 33, datë 29.03.2017 të Kryeministrit “Për miratimin e planit të masave përgatitore për sezonin turistik veror 2017 dhe për krijimin e Task-Forcës së menaxhimit të Sezonit Turistik Veror”.</p> <p>b. DVPQ Shkodër dhe Komisaritet e Policisë të vendosin/përcaktojnë personat/pikat e kontaktit me organet e qeverisjes vendore, agjencitë e turizmit, bregdetit, rajonale të mjedisit, ato turistike dhe aktorët e tjerë që kanë detyrime gjatë sezonit veror, për të bashkëpunuar e marrë masat e nevojshme për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror.</p> <p>c. DVPQ Shkodër dhe Komisaritet e Policisë, të bashkërendojnë masat me institucionet e tjera shtetërore dhe organet e qeverisjes vendore me qëllim, koordinimin e veprimeve të përbashkëta për sezonin turistik, në zbatim të Urdhrit nr. 33, datë 29.03.2017 të Kryeministrit “Për miratimin e planit të masave përgatitore për sezonin turistik veror 2017 dhe për krijimin e Task-Forcës së menaxhimit të Sezonit Turistik Veror”.</p> <p>d. DVPQ Shkodër dhe Komisaritet e Policisë të bashkëpunojnë me aktorët e tjerë si; pushtetin vendor, administratorët e resorteve turistike, operatorë turistik, etj, për të hartuar e miratuar marrëveshje të përbashkëta, me</p>	<p>Drejtoria Vendore e Policisë Drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit</p>	<p>Drejtesit e Policisë</p>	<p>Gjatë gjithë sezonit turistik</p>
----	---	---	-----------------------------	--------------------------------------

<p>qëllim krijimin e kushteve të nevojshme (akomodim, ushqim, ujë, etj) për punën e punonjësve të policisë të angazhuar me shërbime ne plazhe e zona turistike</p> <p>e. Të merren masa për monitorimin e kontrollin e vazhdueshëm të shërbimeve të planifikuara në terren me qëllim zbatimin sa më korrekt të respektimit të të drejtave të qytetarëve, evidentimin e shkeljeve të tjera në detyrë nga ana e punonjësve të policisë dhe për çdo rast të konstatuar, ndaj punonjësve të policisë përgjegjës të fillojë ecuria disiplinore në bazë të Rregullores së Disiplinës të Policisë së Shtetit.</p> <p>f. Në zonat e plazheve Velipojë, Shirokë, Zogaj dhe në rrugët hyrëse të tyre të vendosen tabelat me numrat e telefonit të shërbimeve të policisë, të shërbimeve të emergjencës, bashkëpunimin me organet e qeverisjes vendore për përcaktimin e zonave, rezervuarëve apo ujëmbledhësve duke vendosur tabelat e duhura për mos frekuentimin e tyre nga pushues apo banorë të tjerë</p> <p>g. Sektorët e Luftës Kundër Krimin të Organizuar e Krimeve të Rënda të marrin masa për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë së paligjshme që mund të zhvillohet nga subjekte të palicensura për veprimtari turistike, pranë dhe nëpërmjet PKK, si dhe të kontrabandës dhe trafikeve të tjera të paligjshme; të marrin masat për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë së mundshme kriminale në plazhe dhe zonat turistike, si dhe mbajtjen në kontroll të personave me precedentë penal e kriminal, shëtitës, për tendencën e trafikeve të paligjshme, shpërndarës droge, etj, duke bashkëpunuar ngushtë me organet e prokurorisë për dokumentimin ligjor</p>			
---	--	--	--

<p>të veprimtarisë së tyre.</p> <p>h. Sektorët dhe seksionet për krimet në Komisariate, të marrin masa për;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sigurimin e informacionit të nevojshëm policor për parandalimin e veprave penale, kryesisht vjedhjet e kabinave, makinave, lokaleve të tregtisë, apo vjedhje te tjera, te cilat shqetësojnë pushuesit • Mbajtjen nën kontroll të pikave ku qarkullojnë vjedhës shëtitës, • Ngritjen e pritave apo grackave për kapjen në flagrancë të autorëve të vjedhjeve që mund të kryhen si natën ashtu dhe ditën. <p>i. Ne zbatim te Urdhrit Nr. 186, date 06. 05. 2013 te Drejtorit te Përgjithshëm te Policisë se Shtetit “Për marrjen e masave për shmangien e ngjarjeve me pasoja aksidentale gjate qarkullimit te automjeteve te transportit publik për vizita studimore dhe turistike ne vendin tone”, do te merren masat qe ne te gjithë ato raste kur qarkullojnë grupe te mëdha turistike me autobuze, te ketë informim reciprok me Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë, me qëllim shoqërimin e tyre në formë stafete.</p> <p>j. Seksioni i Hetimit ne DRKM, te bashkëpunoje me Strukturat kundër krimit te organizuar ne DPQ Shkodër dhe te marrin masa për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë se paligjshëm qe mund te zhvillohet nga subjekte te palicensuara per veprimtari turistike, nëpërmjet P.K.K-ve .</p> <p>k. Të bashkëpunohet me Drejtorinë Doganore</p>			
---	--	--	--

	<p>Shkodër për krijimin e mundësive për të na vënë në dispozicion të policisë kufitare zyrat e tyre në PKK. Muriqan gjatë sezonit turistik 2017 me qëllim shtimin e disa posteve pune në këtë PKK</p> <p>l. Te bashkëpunohet me SHISH Shkodër, me sektorin e antiterrorit, seksionin e trafiqeve te paligjshme ne D.P.Q Shkodër, për evidentimin dhe kontrollin e hyrjeve dhe qëndrimit ne territor te shtetasve te huaj, veçanërisht te shtetasve te vendeve me rrisht te lart ne fushën e terrorit.</p> <p>m. Nga ana e PKK. Hani i Hotit, të planizohen shërbime për kontrole të herë pas hershme në zonën turistike Theth për evidentimin dhe kontrollin e shtetasve vendas dhe të huaj që do të frekuentojnë sektorin e kufirit në Bjeshkët e Pejës</p>			
22	<p>Mbikëqyrja e sigurisë në ujërat e brendshme në thellësi të territorit, nëpërmjet rojeve bregdetare, si dhe Marrjen e masave qe rregullojnë veprimtarinë e mjeteve lundruese ne hapësirën detare dhe ne ujërat e brendshme ne thellësi te territorit</p>	<p>Bashkitë Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit</p>	<p>Kryetarët e Bashkive Drejtori i Kufirit dhe Migracionit</p>	<p>Gjatë gjithë sezonit turistik</p>
	<p>Të merren të gjitha masat e nevojshme për parandalimin dhe goditjen e rasteve të abuzimit, shkeljeve të kodit të Etikës së Policisë dhe të drejtat e qytetarëve nga punonjësit e policisë, duke mbajtur qëndrim të rreptë për çdo rast të evidentuar.</p>	<p>Drejtoria Vendore e Policisë, drejtoria Vendore e Kufirit dhe Migracionit</p>	<p>Drejtuesit e Policisë</p>	<p>Gjatë gjithë sezonit</p>

23	Marrja e masave për ruajtjen e destinacioneve turistike (kryesisht zonën e plazhit Velipojë) nga ndotja akustike. Përcaktimi i orarit të zhvillimit të aktiviteteve, veçanërisht orareve të natës.	Drejtoria Rajonale e Mbrojtjes së Mjedisit, Bashkia Shkodër	Klodian Kovaci Voltana Ademi	Gjatë gjithë sezonit turistik
24	Publikimi i hartës së aksidenteve rrugore (Pikat e Zeza) , duke ia bërë te njohura agjencive turistike dhe agjencive të transportit	Autoriteti Rrugor Shqiptar, Sektori i Policisë së Trafikut pranë DVPSH	Shkelqim Sterkaj Maxhun Hajdari	Gjatë gjithë sezonit

SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUAR

